



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 2143 / Prot.  
/  
1

Tiranë 22.7. 2020

Lënda: Mbi shkresën tuaj nr.2709/3 prot., datë 20.07.2020.

**Drejtar:** **Ministrat të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,  
Znj. Besa Shahini**

**Për dijeni:** **Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Sh.T.Z. Ilir Meta**

**Kryeministrat të Republikës së Shqipërisë  
Z. Edi Rama**

**E nderuara zonja Ministre,**

Me shkresën tuaj nr.2709/3 prot., datë 20.07.2020, megjithëse më është drejtar mua personalisht, jam njojur me përbajtjen e saj nga rrjetet sociale në datën 21 korrik 2020. Po në këtë datë ishte e shpallur nga dekanët e fakulteteve të UT në faqet zyrtare të njësive kryesore të UT, pa mbërritur akoma në protokollin e Rektoratit të UT. Zyrtarisht në institucionine UT, kjo shkresë ka mbërritur sot në datën 22 korrik 2020.

Në fakt, kjo gjë nuk është hera e parë që ndodh dhe vërteton gjithmonë edhe më shumë atë çfarë unë kam dekluaruar edhe më parë, pikërisht lidhjen dhe bashkëpunimin tuaj me dekanët e fakulteteve të UT, në të gjitha problematikat që ka patur në këto vite në UT, të krijuara nga ata dhe të mbështetur fuqimisht edhe nga ju personalisht.

Në shkresën tuaj nr.2709/3 prot., datë 20.07.2020, me lëndë “*Mbi procesin zgjedhor në Universitetin e Tiranës*”, në asnjë paragraf dhe fjali të saj, nuk i jeni referuar shkresave të përcjella nga Rektori i UT, të shoqëruara edhe me dokumentacionin përkatës, në lidhje me këtë çështje, kryesisht, shkresës së fundit, me nr.1991 prot., datë 8 korrik 2020.

Pa diskutuar edhe një herë për paligjshmérinë e Urdhërit nr.8 datë 14.01.2020 “*Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë*”, pasi në lidhje me këtë çështje, jam shprehur zyrtarisht me shkresën nr.1450/1 prot., datë 03.04.2020 (bashkëlidhur), për të cilën, edhe në këtë rast, nuk keni gjetur kurajon të shprehni qëndrimin tuaj

institucional, me keqardhje konstatoj se në të gjitha paragrafët e shkresës tuaj, ka gjëra krejtësisht të pavërteta dhe në kundërshtim të hapur me ligjin e arsimt të lartë 80/2015 dhe me Rregulloren e Zgjedhjeve në UT, e cila, ju është përcjellë me shkresën nr.568/3 prot., datë 12.02.2020 të Rektorit të UT, dhe për të cilën, me shkresën tuaj nr.1908 prot., datë 09.03.2020, keni paraqitur edhe vërejtjet tuaja.

Kjo do të thotë që ju duhet ta njihni shumë mirë Rregulloren e Zgjedhjeve të UT dhe përbajtjen e saj.

Në fakt, në rrugëtimin tim si Rektor i UT dhe ju si Ministre e Arsimit, fatkeqësisht, nuk është hera e parë që ndodh kjo gjë, si në korrespondencës zyrtare që kemi patur për çështje dhe problematika të ndryshme që ju kam paraqitur, ashtu edhe në daljet dhe deklaratat tuaja të shpeshta, edhe kur nuk ka ka patur asnjë lidhje me institucionin e Rektorit të UT, ju në të gjitha rastet, keni shpifur dhe keni thënë gjëra aspak të vërteta për Rektorin e UT.

Edhe në këtë rast, nuk kishte si të ndodhë ndryshe, me shkresën tuaj të fundit dhe me paragrafët e saj, **keni dezinformuar** (nuk dua të përdor shprehje tjeter), **institucionet më të larta të shtetit shqiptar, siç është Presidenti i RSH dhe Kryeministri i RSH.**

**Arsyet se përse ju po e bëni këtë gjë edhe në këtë rast, tashmë janë fare të qarta, është përfundimi i gjithë asaj çfarë jeni përpjekur për të bërë në gjithë këto vite, në bashkëpunim të ngushtë edhe me dekanët e fakulteteve të UT, është “marrja peng” e Universitetit të Tiranës.**

Dhe meqënëse ju e njihni mirë Rregulloren e Zgjedhjeve të UT, më lejoni t’ju vë në dukje se Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) i UT, nuk mund të krijohet sipas dëshirave apo qejfeve të askujt, as të Rektorit të UT, as të dekanëve të fakulteteve, dhe as të Ministrit të Arsimit, **por KIZ i UT krijohet vetëm bazuar në nenin 6 të Rregullores së Zgjedhjeve të UT.**

Rregullorja e Zgjedhjeve e UT, i ka të mirëpërcaktuara të gjitha procedurat që duhet të kryhen pas shpalljes së ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri për zgjedhjen e autoriteteve dhe Senatin Akademik të UT, nga autoriteti më i lartë drejtues i Universitetit të Tiranës (*shiko nenin 5, pika 3 të Rregullores së zgjedhjeve të UT*) si dhe ka të mirëpërcaktuara edhe afatet kohore për realizimin e çdo procesi apo procedure që duhet të kryhet gjatë periudhës zgjedhore.

Ju zonja Ministre gjeni guximin dhe flisni për platformën antiplagjaturë që paskërkeni siguruar për çdo IAL, në kuadër kjo, sipas jush, “*të realizimit të Paktin për universitetin*” .... Kjo është një demagogji dhe mashtrim që askush nuk ju beson më, sepse, jeni pikërisht ju dhe institucioni që ju drejtoni që nuk keni bërë asgjë për këtë pakt, por vetëm keni gënjer dhe intimiduar, sikurse po bëni edhe në këtë rast.

Ju vazhdoni dhe dezinformoni përsëri kur citoni se në Universitetin e Tiranës, nuk është krijuar Këshilli i Etikës. Kjo nuk është aspak e vërtetë. **Këshilli i Etikës i UT është miratuar me Vendimin nr.12 datë 11.04.2019 të Senatit Akademik të UT** (bashkëngjitur), dhe ky vendim është i shpallur prej kohësh edhe në faqen zyrtare të UT.

“*Themelimi*”, siç e quani ju, i KIZ i UT, qysh....kur..... (sepse ju nuk e përcaktoni se kur sipas jush duhet të krijohej KIZ), qenkerka arsyeva sipas jush që një grup pedagogësh të UT, ish anëtarë të një prej komisioneve zgjedhore që ka patur UT në këto vite, me mandat të përfunduar dhe jo KIZ ekzistues siç e quani ju, sepse nuk kishte më KIZ pas miratimit të Rregullores së Zgjedhjeve të UT, paskerka vijuar punën për përgatitjen e zgjedhjeve.

Ky është rast i paprecedentë në historinë e arsimit në RSH, sepse **Ministrat përgjegjës të arsimit nuk i intereson aspak as ligji, as rregulli dhe as zbatimi i tyre, kur në fakt, e ka detyrim ligjor sipas nenit 7, pika 2/ e, j) të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, të verifikojë ligjshmërinë e zgjedhjeve në IAL-të.**

Jo zonja Ministre gjeni guximin dhe krahasoni mandatin e Rektorit, me mandatin e anëtarëve të një komisioni zgjedhor që nuk është gjë tjetër, vecse një strukturë që krijohet për të administruar një proces zgjedhor.

Ky krahasim është sa skandaloz dhe po aq fyes për institucionin e Rektorit në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend.

Ju kujtoj se Rektori i një institucioni të arsimit të lartë, dekretohet nga Presidenti i RSH, njësoj si edhe Ministri i Arsimit.

Shkresa juaj e fundit, pavarësisht se më drejtohet mua personalisht (dhe as institucionit të Rektorit të UT), nuk ka asnjë lidhje me atë çfarë ju kam bërë prezent dhe ju kam informuar në vazhdimesi, mbi atë çfarë po ndodh në UT në lidhje me procesin zgjedhor.

Ju mbushni faqet e shkresës tuaj me paragrafë të tërë, por në fakt, në asnjë fjali të saj, nuk guxonit të merreni me këtë çështje dhe ta trajtoni atë siç duhet dhe siç është ligji dhe rregulli, sepse, sigurisht, nuk mund ta bëni këtë gjë, sepse e verteta është ajo që unë ju kam bërë me dije, me fakte dhe prova të pakundërshtueshme.

Ju shpreheni se “*ju paskam zhgënjer*”, megjithëse të them të vërtetën, kjo fjali, e thënë nga ju, nuk ka asnjë vlerë për mua.

Në fakt, ju jeni i zhgënjesi më i madh i nxënësve, i maturantëve, i studentëve dhe i të gjithë të rinjve të Republikës së Shqipërisë dhe i ëndërrave të tyre; ju jeni Ministri i Arsimit që nuk ka asnjë lidhje me arsimin; ju jeni personi që vetëm zyrtarin e shtetit nuk diti të bëjë dhe që nuk zbatoji asnjë ditë të punës së tij, as ligjin dhe as rregullin.

Ju shpreheni në fund të shkresës tuaj, se: “.... *paskeni vlerësuar se veprimet përgatitore për zhvillimin e procesit zgjedhor, kanë qenë plotësisht brenda parashikimeve ligjore.....*”

Zonja Ministre, si e bëtë këtë vlerësim? Mbi bazën e kujt informacioni apo dokumentacioni jeni bazuar pë të arritur në këtë përfundim? Kush ju ka dhënë këtë informacion?

Këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave si këto, keni detyrim ligjor dhe moral t'i përgjigjeni për të sqaruar të gjithë personelin akademik dhe studentët e Universitetit të Tiranës, por edhe mbarë opinionin publik.

Si përfundim, edhe një herë deklaroj se në datën 30 korrik 2020, në Universitetin e Tiranës, nuk mund të zhvillohen zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe për anëtarë të Senatit Akademik të UT, në kushtet e pamundësisë të Senatit Akademik për të miratuar KIZ, të kaosit dhe konfuzionit të shkaktuar nga disa ish-personel akademik i UT, në bashkëpunim të ngushtë me dekanet e fakulteteve të UT, kryesisht me Dh.Kule dhe A.Hoxha. Shkresa juaj e fundit e vërteton këtë bashkëpunim për të legjitimuar paligjshmërinë e procesit zgjedhor në Universitetin e Tiranës.

Në zbatim të nenit 7, pika 2/e, j, të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, si institucioni që duhet të kontrollojë pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në tërësi, si dhe ligjshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve, ju kërkoj edhe një herë me forcë, të vlerësoni informacionin dhe dokumentacion që ju kam përcjellë në lidhje me procesin zgjedhor në Universitetin e Tiranës, për të bërë verifikimet e nevojshme për të gjitha sa ju kam informuar dhe sqaruar.

Në rast të kundërt, përgjegjësia do të jetë vetëm e juaja dhe paligjshmëria do të shoqërojë të gjithë këtë proces zgjedhor dhe mandatin e autoriteteve të reja drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës.

